

KONTRATE SHITJE KUOTASH TE KAPITALIT TE REGJISTRUAR

Sot me date 21/01/2025 ne palet e meposhteme vendosëm perpilimin e kesaj kontrate shitje kuotash te kapitalit:

PALA SHITËSE

Z.Orel Mehja, qytetar shqiptar e lindur ne daten 16.06.1975, i paisur me leter njoftimi nr 039591846 .

PALA BLERËSE

Zn.Daniela Dishani , qytetar shqiptar e lindur ne daten 10.08.1983, i paisur me leter njoftimi nr 035977751.

Palet me vullnet të plotë përpilojne kete kontrate:

PËRMBAJTJA E KONTRATËS

Pala shitëse e kuotes se kapitalit është ortak i shoqërisë “TV SKAMPA” sh.p.k e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit shqipëtar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me numër Nipt K62610201Q .

Pala shitëse zoteron nje kuote te kapitalit te shoqerise qe perfaqeson 66.67 % te kapitalit te regjistruar te saj me vlere nominale 6.666.667 leke.

NENI 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Pala shitëse Shoqeria “TV SKAMPA” shpk, i shet bleresit, znj. Danjela Dishani , qytetare shqiptare e lindur ne daten 10.08.1983, i paisur me leter njoftimi nr 035977751 nje kuote te kapitalit te shoqerise qe perfaqeson 66.67% te kapitalit te regjistruar, ose me vlere nominale 6.666.667 leke.

NENI 2

ÇMIMI DHE MËNYRA E PAGESËS

Për blerjen e kuotes të shoqërisë, objekt i kësaj kontrate, blerësi Znj. Danjela Dishani , qytetare shqiptare e lindur ne daten 10.08.1983, i paisur me leter njoftimi nr 035977751, ka detyrim t'i paguajë shitësit cmimin me shumën totale prej 6.666.667 leke. (Gjashte milion e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e shtate leke).

Palet bien dakord qe cmimi i blerjes te behet nepermjet llogarise bankare, ose me forma te tjera.

NENI 3 TRANSFERIMI I KAPITALIT

1. E drejta e pronësisë mbi Kuoten e palës shitëse, i kalon palës blerëse në momentin e nënshkrimit të kontratës.
2. Pala shitëse i dorëzon palës blerëse të gjitha dokumentat, deklaratat, ose certifikatat e nevojshme për përfundimin e transferimit të pjesëve të kapitalit themeltar në favor të palës blerëse dhe për regjistrimin e këtij transferimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
3. Pala shitëse mbas nënshkrimit të kësaj kontrate për transferimin e kuotes, nuk është me ortak i shoqërisë.
4. Pala blerëse mbas nënshkrimit të kësaj kontrate për transferimin e kuotes, bëhet zotëruese e 66.67 % të kapitalit themeltar të shoqërisë "TV SKAMPA" shpk, me një vlerë nominale prej 6.666.667 leke.

NENI 4 DEKLARATA DHE GARANCI

Pala shitëse deklaron dhe garanton palën blerëse për sa më poshtë vijon:

1. Pala shitëse është pronare e ligjshme e kuotes që i shet palës blerëse, e cila është plotësisht e nënshkruar dhe e paguar;
2. Shoqëria ka dorëzuar të gjitha deklaratat e raportimet e tatimeve që kërkohen të dorëzohen sipas ligjit dhe ka paguar të gjitha vlerësimet tatimore, tarifatat dhe detyrime të tjera shtetërore për shoqërinë, pasurinë e të ardhurat e saj, që sipas ligjit janë të detyrueshme për t'u paguar;
3. Shoqëria nuk është në shkelje të ndonjë marveshjeje me të cilën është palë;
4. Shoqëria nuk është palë, as nuk është në dijeni të ndonjë rreziku për ndjekje gjyqësore, arbitrazhi, apo administrative, rezultati i së cilës mund të kishte efekt material negativ për shitjen e pjesëve të kapitalit themeltar.

NENI 5 DETYRIMET TATIMORE

Pala blerëse pranon të përfitojë kuoten e kapitalit si më sipër, me gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të bilancit të shoqërisë deri në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate.

NENI 6 KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kjo kontratë do të rregullohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin shqipëtar. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me këtë kontratë, mund të zgjidhet me çdo marrëveshje tjetër, me mirëkuptim midis palëve, përndryshe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve, në lidhje me çështjet që trajton dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, qoftë me gojë apo me shkrim, midis palëve.

Pavlefshmëria ose pabazueshmëria e njërës nga dispozitat e kësaj kontrate nuk do të çënojë vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një marrëveshje ligjërish të vlefshme, që korresponon sa më shumë të jetë e mundur me synimet e palëve.

NJOFTIMET

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet mes palëve do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen si të dhëna në mënyrë të rregullt nëse i dorëzohen në dorë, i dërgohen me postë të regjistruar ose me faks palës në adresën e paracaktuar nga palët.

DISPOZITA E FUNDIT

Kjo kontratë është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe me të njëjtën vlerë secila, në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil (të ndryshuar) si edhe të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

PALËT

PALA SHITESE
TV SKAMPA

Orël Mehja



PALA BLERESE
Danjela Dishani

